

VENDIM
Nr. 53, datë 25.1.2017

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQES NË
EKONOMINË PYJORE “KRASTË-KRUJË”, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA
“ANTEA CEMENT” SHA, PËR AKTIVITET MINERAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9813, datë 1.10.2007, “Për miratimin e marrëveshjes minerare të shfrytëzimit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Antea Cement” sh.a.”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 23,4 (njëzet e tre presje katër) ha në ngastrat 1b, 2a dhe 2b të ekonomisë pyjore “Krahtë-Krujë”, që do të përdoret nga shoqëria “Antea Cement” sh.a., për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror, hiqet nga Fondi Pyjor dhe Kullor dhe çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Sipërfaqja sipas ngastrave pyjore dhe kullorore jepet në tabelën nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Heqja nga Fondi Pyjor Kullor për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror nga shoqëria “Antea Cement” sh.a., bëhet me pjesë bazuar në grafikun e parashikuar të punimeve sipas lejes mjedisore dhe, mbi këtë bazë, shoqëria “Antea Cement” sh.a., realizon rehabilitimin mjedisor të territorit pyjor.

3. Vlerat përkatëse të pakësimit në volum të lëndës drusore dhe produkteve të tjera pyjore, sipërfaqet dhe investimet e kryera në vite në Fondin Pyjor dhe Kullor, objekt i këtij vendimi, paguhen nga shoqëria “Antea Cement” sh.a., në bazë të lidhjes 4, bashkëlidhur vendimit nr. 1064, datë 22.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave””.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Antea Cement” sh.a., brenda 3 (tri) viteve, të pyllëzojë me fondet e veta 23,4 (njëzet e tre presje katër) ha sipërfaqe me drurë pyjorë, në ngastrat pyjore të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur ndërmjet shoqërisë “Antea Cement” sh.a., dhe Ministrisë së Mjedisit.

5. Sipërfaqja pyjore sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit, regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në funksion të lidhjes së marrëveshjes me shoqërinë “Antea Cement” sh.a.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, bëhen ndryshimet përkatëse në regjistrin e Kadastrës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave dhe në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme publike.

7. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “Antea Cement” sh.a., nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për hartimin e projekteve teknike të heqjes së materialit drusor dhe pyllëzimin e sipërfaqeve pyjore sipas pikës 4 të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN
NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR AKTIVITETIN MINERAR
TË SHOQËRISË “ANTEA CEMENT” sh.a.

QARKU DURRES			Lidhja 1
ID Prones	Ekon.Pyjore/Kullorore	Ngastra	Sip. qe hiqen (ha)
113	Kraste- Kruje	1b	3.48
114	Kraste- Kruje	2a	13.26
114	Kraste- Kruje	2b	6.66
GJITHSEJ			23.40

